

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Macaulay Culkin përlotet në Emmy për Catherine O'Hara! "Ajo ishte mamaja ime" Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/macaulay-culkin-per-lotet-ne-emmy-per-catherine-ohara-ajo-ishte-mamaja-ime/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 22:03:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 21:59:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	16cac7901dc7206cee8bc8ac4163f8ff0a2c8d5e0984d5ef0433af663d2d1c819
TEKSTI	b33a5eb6a4ee5c4a717f41cbeb23dfcc891eb07d4ba36d4a984b2d3f565b8ad4
PAMJA	72176c0beb0420c0f9dc4c655702da578d2554d5b691a6099254b7df6ecd825d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	08c86b6942cefd1f4c7ef6226eefff5c931c33bf7327bb27eb53777eacae8cd0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af8861206e6114019e8ba4a90e43cee776f0f9a8970bb3a57725a194fa0151bc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/08c86b6942cefd1f4c7ef6226eefff5c931c33bf7327bb27eb53777eacae8cd0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Macaulay Culkin përlotet në Emmy për Catherine O'Hara! "Ajo ishte mamaja ime"



Redaksia K

15 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Një nga momentet më emocionuese të ceremonisë së 78-të të Emmy Awards ishte homazhi për aktoren e ndjerë Catherine O'Hara, ku **Macaulay Culkin** nuk mundi t'i mbante lotët teksa kujtonte gruan që për miliona njerëz mbetet "mamaja" e Kevin McCallister në "Home Alone".

Culkin iu bashkua në skenë Annie Murphy dhe Dan Levy, dy aktorët që luajtën fëmijët e O'Hara në "Schitt's Creek", për të nderuar kujtimin e aktores gjatë segmentit "In Memoriam". O'Hara u nda nga jeta më 30 janar 2026, në moshën 71-vjeçare.

Duke folur për të, **Culkin** e nisi me një referencë prekëse ndaj rolit të saj në "Home Alone", ku O'Hara luante Kate McCallister, nënën e Kevin-it.



E kujtojmë si nënën harraqe, apo jo? Por unë nuk do ta harroj kurrë

-tha ai, duke iu referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë historisë së filmit.

Më pas, zëri i tij u bë më emocional teksa shpjegoi se marrëdhënia e tyre nuk ishte thjesht ajo e dy aktorëve që kishin ndarë ekranin.



Ka shumë fjalë që mund të përdor për ta përshkruar Catherine. Ajo ishte inkurajuese, e ngrohtë, qesharake, por fjala që më vjen në mendje është 'mama'

tha Culkin.



Ajo nuk ishte vetëm gruaja dhe nëna e Bo, Matthew dhe Luke. Ajo ishte mamaja ime. Ajo ishte mamaja jonë dhe, në një farë mënyre, mamaja e të gjithëve ne

-vijoi aktori.

Culkin shfrytëzoi gjithashtu momentin për t'u drejtuar publikut me një mesazh të thjeshtë, por tepër emocional: të mos harrojnë njerëzit që kanë pranë.



Telefonojeni nënën tuaj sonte. Përnjëmend. Jepuni një përqaftim mamave

-tha ai.

Aktori kujtoi gjithashtu se, edhe shumë vite pas përfundimit të filmave "Home Alone", O'Hara vazhonte të ishte aty për të. Sipas Culkin, ajo "gjithmonë shfaqej" kur ai kishte nevojë për të, një cilësi që ai e konsideronte pjesë të veçantë të karakterit të saj.

Në fund ai iu rikthye me humor të hidhur historisë së filmave ku Kate McCallister "harron" dialin

e saj Kevin jo një, por dy herë.

“Ajo mund të më ketë harruar dy herë, por ne do ta kujtojmë gjithmonë

-tha Culkin.

Edhe Annie Murphy dhe Dan Levy ndanë kujtimet e tyre për O'Hara, duke folur për humorin, krijimtarinë dhe bujarinë e saj. Murphy tregoi se edhe pas vdekjes së aktores kishte hasur njerëz të panjohur që ndanin me të histori dhe kujtime për të, ndërsa Levy tha se mësimi më i madh që kishte marrë prej saj ishte:

“Gjithmonë thuaj po.

Catherine O'Hara la pas një karrierë prej pesë dekadash, nga “SCTV” dhe filmat “Home Alone” e “Beetlejuice”, deri te roli ikonë i Moira Rose në “Schitt's Creek”, për të cilin fitoi një Emmy.

Për **Culkin**, megjithatë, ajo nuk do të mbetet thjesht një aktore e madhe. Në skenën e Emmy-ve, ai e bëri të qartë se për të dhe për miliona njerëz që u rritën me “Home Alone”, Catherine O'Hara do të jetë gjithmonë një figurë shumë më personale: mamaja që nuk do të harrohet kurrë.

LAJME TË NGJASHME



Florence Pugh shfaqet si një perëndeshë në Emmy!

2 MIN



Selena Gomez shkëlqen si një statujë e artë në Emmy!

2 MIN



Macaulay Culkin emocionon fansat me një mesazh të rrallë për Brenda Song pas 9 vitesh dashuri!

1.5 MIN



“Mendova se kishim ende kohë...” Rrëfimi prekës i Macaulay Culkin për Catherine O'Hara!

1 MIN



“Fëmijët duhet të kenë pak frikë...” Macaulay Culkin dhe Brenda Song përdorin “Home Alone” si mësim për djemtë e tyre?

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë “Air



Arrestet e Erion Veliajt, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



“Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë...”/ Shkënda Lili habit



Rëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish



Kujtimet në Top Channel dhe dashuria për ekranin, "rikthehet" Albana Osmani: Do të doja të bashkëpunoja me Ledionin...



Sydney Sweeney pozon nudo për reklamën e re dhe shpërthen polemika? "Po seksualizohet sporti..."



Për kë vazhdon të blejë lule te dyqani i motrës së Stelinës? Miri zihet ngushtë: Për atë...



Makina përplas 69-vjeçarin me biçikletë, ndërron jetë rrugës për Tiranë!



"E ëma e qëlloi me gur për ta vrarë", Pastor Vilajeti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi!

EDITORI SUGJERON



Nga dëshira për të prekur "Eurovisionin" deri tek situata më e sikletshme në koncert, flet Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më të zakonshme na fusin në alarm...



"Po du", Rilind Alimani tregon si arriti të realizojë bashkëpunimin me Elvana Gjatën: I kam shkruar që...



Truku i thjeshtë që ua heq lëkurën specave pa mundim, mjafton një hap pas pjekjes!



"Eksperimentova, shkoi shumë mirë"/Egri Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat...



Të dobët dhe e keni të vështirë të shtoni peshë?! Proveni këto ushqime...




Të gjithë po shtojnë ekrane, Range Rover po bën të kundërtën!



Jeni të mërzhitur?! Bëni mirë të hani këto ushqime...



Mendoni se partneri juaj po ju tradhton?! Ja se si duhet të flisni me atë...



Fëmija juaj po kalon një krizë zemërimi?! Mos i bëni këto gabime...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakttoni
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.